



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 45, datë 20/07/2022

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË VEPRIMTARISË SË
PËRGJITHSHME DHE ASAJ MËSIMORE TË NJËSISË BAZË
“INTERPRETIM” TË FAKULTETIT TË MUZIKËS NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 3, pikën 1 shkronjat a, dh dhe f të nenit 38 si dhe të pikave 1, 4 dhe 6 të nenit 39 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; shkresën e Dekanatit të Fakultetit të Muzikës me nr. 223 prot., datë 20.07.2022 (protokolluar në Rektorat me nr. 1245/2 prot., datë 20.07.2022) për dërgimin e Rregulloreve të njëjësive bazë të Fakultetit të Muzikës; KMDP, INTERPRETIM dhe KANTO për miratim në Senat Akademik të UA, dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregulloreve të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Departamentit INTERPRETIM të Fakultetit të Muzikës”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Muzikës, Departamenti Interpretim .
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe të transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Blv. “Dëshmoret e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 225 488, www.ua.edu.al



Page1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc.Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

Erlind FUSHA (Student FAB)



Handwritten signature

Handwritten signature





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT

Nr. 221 / Prot.
1

Tiranë, më 28 02 2022

RREGULLORE
E VEPRIMTARISË SË PËRGJITHSHME
DHE ASAJ MËSIMORE
E DEPARTAMENTIT TË INTERPRETIMIT
PRANË FAKULTETIT TË MUZIKËS

MIRATUAR
ME VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK
NR. _____, DATË ____ / ____ / 2022



KREU I

PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma juridike

Departamenti i Interpretimit (DI) është një nga njësitë bazë të Fakultetit të Muzikës (FM), në Universitetin e Arteve të Tiranës (UART) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore në fushën e muzikës.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja e Departamentit të Interpretimit (DI) mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të Veçantë të Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UART, në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e Fakultetit të Muzikës si dhe në Rregulloret e cikleve të studimit të UART

Neni 3

Departamenti i Interpretimit

1. Departamenti i Interpretimit është njësi bazë, pjesë përbërëse e njësisë kryesore, Fakultetit të Muzikës (FM) dhe është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
2. Departamenti i Interpretimit nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë artistike-kërkimore-shkencore.
3. Departamenti i Interpretimit ka në përbërje të tij stafin akademik të punësuar me kohë të plotë, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Neni 25. Departamenti mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik.
4. Departamenti mund të organizohet me grupe mësimore/grupe të përhershme ose të përkohshme, me karakter artistik-kërkimor-shkencor. Këto grupe propozohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohen, me votim të hapur, me vendim të Dekanatit. Dekani i FM, pas votimit të hapur në Dekanat, përcjell vendimin për ngritjen e grupeve mësimore pranë Departamentit të Interpretimit tek Rektori i UART për miratim përfundimtar. Titullar i këtij grupi do të caktohet sipas propozimit të drejtuesit të njësisë bazë. Ai nuk ka të drejtë në vendimmarrje por zbaton rregulloret dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe garanton respektimin e lirisë akademike të personelit.
5. Mbledhjet e Departamentit të Interpretimit thirren nga Përgjegjësi i tij ose me kërkesë me shkrim të 1/3 së anëtarëve të këtij Departamenti.
6. Departamenti i Interpretimit ushtron këto kompetenca:
 - a) Është përgjegjës për programet e studimit që ofron vetë. Harton përmbytjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse. Kujdeset vazhdimisht për përditësimin e tyre;
 - b) Propozon hapjen, riorganizimin, përshtatjen ose mbylljen e programeve të studimeve sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) Harton planin strategjik të zhvillimit të Njësisë Bazë sipas nevojave dhe kërkesave të

Neni 4

Misioni dhe Qëllimet e

Departamentit të Interpretimit

- 1 Departamentit i Interpretimit është një nga tre Departamentet, pjesë përbërëse e Fakultetit të Muzikës (FM).
- 2 Departamenti i Interpretimit ka për qëllim kryesor organizimin e procesit të mësimdhënies, atij artistik-kërkimor-shkencor, zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale të dijes në fushën e muzikës.
- 3 Departamenti i Interpretimit promovon zhvillimin e studimit, procesit mësimor artistik-kërkimor-shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës, kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimin dhe hapjen ndaj komunitetit artistik-shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimin me administratën shtetërore dhe lokale.
- 4 Departamentit i Interpretimit aspiron përmbushjen e misionit të tij në frymën e lirisë, respektit ndaj dinjitetit human, pluralizmit të ideve dhe transparencës së procedurave. Ky departament promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve.
- 5 Personeli akademik, jo akademik dhe studentët e Departamentit të Interpretimit bashkëpunojnë në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre të njohura nga legjislacioni në fuqi për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale.
- 6 Departamenti i Interpretimit mbikqyr cilësinë e mësimdhënies në të gjitha programet e studimit të ofruara prej tij. Ai vepron në fushën e formimit artistik-kërkimor-shkencor dhe profesional në përmbushje të misionit të UART. Gjithashtu ai punon edhe si kultivues, ruajtës dhe promovues i kulturës kombëtare.

Neni 5

Liria akademike

Personeli akademik në Departamentin e Interpretimit gëzon lirinë akademike në procesin mësimor dhe veprimtarinë artistike-kërkimore-shkencore. Liria akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së ideve, opinioneve dhe metodave të punës akademike. Garanton zhvillimin e lirë, kritik e krijues të mësimdhënies, të veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore si dhe të shërbimeve në përputhje me standardet e cilësisë. Liria akademike ushtrohet në përputhje të planeve dhe programeve mësimore të hartuara dhe të miratuara nga Departamenti.

Neni 6

Fusha e veprimit

Kjo rregullore i shtrin efektet e saj mbi të gjitha strukturat, autoritetin drejtues, personelin akademik, studentët e programet e administruara në Njësinë Bazë si dhe personelin ndihmës akademik apo administrativ, nëse ka, në bashkërendim me drejtuesin e njëjës kryesore.



- tregut;
- d) Është përgjegjës për fushat artistike-kërkimore-shkencore të tij ose të secilit grup mësimor-artistik-kërkimor që ka në përbërje. Kjo në përputhje me saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave artistike-kërkimore-shkencore dhe për mbulimin e tyre me stafin përkatës dhe kualifikimin e këtij stafi në vazhdimësi;
 - e) Menaxhon fondet bazë të veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore përcaktuar nga UART si dhe fonde të tjera të fituara nga veprimtari të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare pas miratimit nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore;
 - f) Për çdo vit akademik, propozon numrin e studentëve për çdo program studimi në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve shtetërore të cilësisë;
 - g) Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga Dekani i FM, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore;
 - h) Propozon kriteret e pranimeve në ciklet e studimit për secilin program studimi të ofruar;
 - i) Propozon tarifat e shkollimit për secilin program studimi;
 - j) Mund të ofrojë shërbime për të tretë dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me disiplinat që ofron, pas miratimit nga drejtuesi i njësisë kryesore;
 - k) Propozon riorganizimin ose mbylljen e njësisë bazë;
 - l) Vlerëson, miraton ose jo dosjet e kandidatëve për fitimin e titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Dosjet pas vlerësimit i përcillen drejtuesit të njësisë kryesore;
 - m) Ndjek kualifikimin artistik/shkencor në doktoratë sipas Rregullores përkatëse dhe vlerëson dosjet e kandidatëve për gradën shkencore “Doktor” përpara paraqitjes së tyre pranë Komisionit të përhershëm për Dhënien e Gradë Shkencore si dhe vlerëson dosjet e kandidatëve për titullin Lektor bazuar në VKM Nr. 145, datë 10.03.2021;
 - n) Paraqet kërkesa për punësimin me kontratë për periudha të shkurtra kohore të studiuësve, personaliteteve, artistëve vendas apo të huaj, për plotësimin e nevojave mësimore, artistike-kërkimore-shkencore të njësisë bazë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - o) Miraton vitin akademik sabbatik për personelin akademik sipas kërkesës së këtij të fundit, Statutit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
 - p) Përcakton kriteret e punësimit për personelin akademik dhe atë ndihmës akademik, nëse ka, të cilat ia dërgon drejtuesit të njësisë kryesore për miratim;
 - q) Propozon në dekanat listën për personelin akademik me kontratë të përkohshme;
 - r) Përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë në komisionet *ad hoc* të punësimit për personelin akademik dhe ndihmës akademik, në përputhje me përcaktimet e Statutit;
 - s) Përcakton fushat e kërkimit artistik dhe shkencor për doktoratat dhe zhvillon programet e studimit të doktoratave sipas fushave të miratuara;
 - t) Propozon strukturën, kohëzgjatjen dhe kreditet e programeve të formimit të vazhduar;
 - u) Ngre komision për njohjen dhe transferimin e plotë ose të pjesshëm të krediteve dhe njohurive të fituara nga një student që transferohet ose ka aplikuar për rifillimin e studimeve, të cilën ia dërgon drejtuesit të njësisë kryesore për miratim;
 - v) Vlerëson dhe raporton në mënyrë vjetore mbi punën mësimore artistike-kërkimore-shkencore, duke evidentuar arritjet, përparësitë, kufizimet, vështirësitë dhe objektivat për të ardhmen.

7. Departamenti i Interpretimit shprehet me vendim për ushtrimin e kompetencave të tij.



KREU II
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I DEPARTAMENTIT

Neni 7

Drejtuesi i njësisë bazë/Departamenti

1. Drejtuesi i njësisë bazë DI, zgjidhet nga personeli akademik me kohë të plotë i kësaj njësie për një afat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë dhe është autoriteti drejtues akademik i saj.
2. Drejtuesi i njësisë bazë/departamentit koordinon veprimtarinë akademike dhe atë artistike-kërkimore-shkencore, drejton punën e njësisë, sikurse dhe e përfaqëson duke u mbështetur në vendimmarrjet e njësisë sipas detyrimeve ligjore dhe atyre të parashikuara në Statutin e UART. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) duhet të jenë personel akademik i kategorisë “Profesor” ose të ketë gradën “Doktor” të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të BE-së ose të OECD-së. Në mungesë të kandidaturave me këtë titull/gradë dhe për efekt të përfaqësimit, mund të kandidojë edhe personeli akademik me kohë të plotë me gradën “Doktor” të fituar në Shqipëri;
 - b) duhet të ketë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 vjet dhe të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - c) të ketë veprimtari të spikatur akademike, artistike ose kërkimore e shkencore;
 - d) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Neni 8

Funksionet e Drejtuesit të Departamentit

- 1 Drejtuesi i Departamentit ushtron këto funksione:
 - a) drejton të gjithë veprimtarinë dhe përfaqëson departamentin;
 - b) nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë artistike-kërkimore-shkencore,
 - c) propozon organizimin në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e tij.
 - d) propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.
 - e) propozon kriteret e pranimi të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e dhe LAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i Njësisë Kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e UART.

- f) ofron shërbime për të tretë, si dhe zhvillon veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.
- g) menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor dhe veprimtarisë artistike, apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare, për njësinë bazë.
- h) drejton e kontrollon të gjithë punën mësimore, artistike e shkencore në departament;
- i) është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë dhe përmbushjen e detyrave të saj;
- j) kontrollon plotësimin e dokumentacionit mësimor, regjistrat dhe çdo dokument që i shërben mësimdhënies, të cilin e ruan dhe e dorëzon në protokollin pranë rektoratit sipas rregullave dhe legjislacionit për arkivat në RSH.
- k) lidh marrëveshjen për organizimin e kohës vjetore të punës për secilin personel akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregulloreve ose akteve të tjera të miratuara në UART.
- l) përcakton dhe mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia, pozicionit të punës, eksperiencës së stafit akademik, fushës së ekspertizës dhe llojit të lëndëve, sikurse dhe sigurohet për përmbushjen e saj;
- m) ndjek veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore në departament në përputhje me planifikimin vjetor dhe mban dokumentacionin e aktivitetit artistik-kërkimor-shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit;
- n) mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e përcaktuar dhe të kërkimeve artistike-shkencore dhe veprimtarive të tjera;
- o) ndjek paraqitjen dhe disiplinën në punë të anëtarëve të njësisë bazë duke u siguruar për mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrimeve dhe njëkohësisht të të drejtave të tyre;
- p) paraqet në dekanat kërkesat me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare të njësisë bazë;
- q) evidenton, verifikon dhe, kur është rasti, i propozon dekanatit, masat për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e departamentit sipas përcaktimeve në Statut dhe rregulloret e tjera të UART;
- r) miraton mënyrën e vlerësimit të studentëve dhe ngre komisionet e provimeve në lëndët që mbulon departamenti;
- s) jep miratimin paraprak për angazhimin e personelit në një tjetër institucion të arsimit të lartë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
- t) bazuar në parashikimet e Statutit të UART, Kodit të Etikës dhe legjislacionit në fuqi në RSH, propozon largimin/pezullimin nga detyra të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, për shkelje të rënda dhe të përsëritura si dhe marrjen e masave të tjera disiplinore;
- u) ushtron detyra të tjera të përcaktuara sipas nevojës të Dekanatit dhe Rektoratit.

2. Në përmbushje të detyrave sa më sipër, autoriteti drejtues i njësisë bazë zhvillon analiza periodike të punës, mësimdhënies, projekteve artistike-kërkimore-shkencore dhe për raste të tjera të veçanta që mund të dalin.

3. Përgjegjësi i Departamentit në ushtrim të funksioneve të tij shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.



Neni 9

Grupet mësimore-artistike-kërkimore brenda departamentit DI dhe midis departamenteve

1. Departamenti i Interpretimit mund të ngrëjë grupe mësimore-artistike-kërkimore, në përputhje me fushat artistike-kërkimore-shkencore, mbështetur në grup-lëndët kryesore, sikurse dhe, kur e shohin të arsyeshme, grupe me karakter artistik-kërkimor.
2. Grupi ka në përbërje të paktën 3 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, ku të paktën njëri të jetë me gradë shkencore/titull akademik.
3. Grupi është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron programi i studimit sikurse dhe lëndët e mbuluara nga stafi i tij akademik në programet e tjera të studimit pranë Departamentit të Interpretimit, ose Departamenteve të tjera brenda FM. Programet e lëndëve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, hartohen nga pedagogu i lëndës dhe i dorëzohen kryetarit të grupit, i cili ia përcjell Përgjegjësit të Njesisë Bazë për miratim.
4. Grupi mësimor mblidhet të paktën 1 (një) herë përgjatë vitit akademik për të trajtuar problematika të ndryshme.
5. Mbledhjet e grupit mësimor caktohen nga kryetari i grupit por mund të thirren edhe nga 2/3 e anëtarëve të tij. Në të gjitha rastet, anëtarët e grupit mësimor njoftohen 3 (ditë) përpara mbledhjes dhe vihen në dijeni për problematikën që do të adresohen.
6. Për çdo mbledhje të grupit mësimor mbahet procesverbal;
7. Grupi mësimor drejtohet nga kryetari/kryetarja e tij;
8. Kryetari/Kryetarja e grupit mësimor emërohet dhe shkarkohet nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë DI.

Neni 10

Funksionet e Kryetarit të Grupit Mësimor

Kryetari i grupit mësimor ushtron funksionet si më poshtë vijon:

- a) Bazuar në urdhërin e Përgjegjësit të Njesisë Bazë, DI organizon hartimin e programeve të lëndëve (Syllabuseve) që mbulon grupi dhe ia paraqet Përgjegjësit të Njesisë Bazë për miratim;
- b) Në përfundim të çdo viti akademik organizon analizën vjetor të grupit mësimor e cila duhet të miratohet me shumicë të thjeshtë nga stafi akademik me kohë të plotë pranë grupit përkatës;
- c) Mbikqyr hartimin e marrëveshjeve për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar dhe i dorëzon për miratim në Departamentin e Interpretimit sipas afateve të përcaktuara;
- d) Në përfundim të vitit akademik depoziton në departament dokumentacionin e aktivitetit artistik/shkencor të secilit anëtar të grupit mësimor;
- e) Bazuar në urdhërin e Drejtuesit të Njesisë Bazë, organizon dhe mbikqyr, hartimin e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore dhe i dorëzon pranë Njesisë Bazë për miratim;
- f) Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor kërkimor.
- g) Evidenton, verifikon dhe kur është rasti i propozon përgjegjësit të departamentit për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e grupit.

KREU III
PERSONELI AKADEMIK I
DEPARTAMENTIT TË INTERPRETIMIT

Neni 11

Personeli akademik

1. Personeli akademik i Departamentit të Interpretimit kryen veprimtari të mësimdhënies, artistike-kërkimore-shkencore, shërbime në mbështetje dhe zhvillim të Fakultetit të Muzikës dhe UART, këshillim për studentët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në Departamentin e Interpretimit, për vetë organizimin e strukturës së tij mësimore, përbëhet nga personeli akademik i lëndëve speciale, artistike, profesionale si dhe personeli akademik i lëndëve teorike.
3. Personeli akademik mund të jetë me drejtim mësimor dhe/ose artistik-kërkimor-shkencor. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesor;
 - b) lektor;
 - c) asistent-lektor.
4. Kategoritë e personelit akademik janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UART dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të Veçantë të Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.
5. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në kontratën individuale vjetore nga Departamenti i Interpretimit.
6. Përzgjedhja e personelit akademik me kohë të plotë si dhe atij të ftuar bëhet me konkurim publik në zbatim të Statutit të UART.
7. Departamenti i Interpretimit mund të ftojë dhe personel akademik me kontratë me afat. Kjo në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Statutit të UART.

Neni 12

STATUSI I PERSONELIT AKADEMIK

1. Personeli akademik i Departamentit të Interpretimit gëzon status dhe trajtim të veçantë në zbatim të VKM Nr. 329, datë 12.4.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”. Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik lidhet me angazhimet e tij në veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore apo me institucionet shtetërore.
2. Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik përcaktohen në kontratën vetjake të punës, në Kodin e Punës dhe në Statutin e UART.

Neni 13

Kontributi i personelit akademik

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi personeli akademik i Departamentit të Interpretimit, gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:



- 21 Të gjitha Programet Mësimore dhe Syllabuset e hartuara nga personeli akademik i Departamentit të Interpretimit në dobi të procesit mësimor janë pronë intelektuale dhe materiale e Departamentit dhe FM. Ato nuk mund të tjetërsohen, huazohen apo jepen në institucione apo individëve të tjerë pa miratimin më parë nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati i FM.
- 22 Rregullime të mëtejshme për mënyrën e realizimit të kontributit të personelit akademik, përcaktohen në aktet administrative individuale të personelit të dala nga Dekani ose Rektori.

KREU IV ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 14

Organizimi i Programeve të studimit në Departamentin e Interpretimit

1. Pranë Departamentit të Interpretimit, në FM, ofrohen programe studimi të Ciklit të Parë, dhe të Ciklit të dytë, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".
2. Programet e studimit që ofrohen në Departamentin e Interpretimit janë:
 - a) Bachelor në Piano;
 - b) Bachelor në Fizarmonikë Klasike;
 - c) Bachelor në Violinë;
 - d) Bachelor në Violë;
 - e) Bachelor në Violonçel;
 - f) Bachelor në Kontrabas;
 - g) Bachelor në Kitarë;
 - h) Bachelor në Flaut;
 - i) Bachelor në Oboe;
 - j) Bachelor në Klarinetë;
 - k) Bachelor në Fagot;
 - l) Bachelor në Korno;
 - m) Bachelor në Trombë;
 - n) Bachelor në Trombon;
 - o) Bachelor në BasTubë;
 - p) Master i Arteve në Piano dhe Mësuesi;
 - q) Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi;
 - r) Master i Arteve në Violë dhe Mësuesi;
 - s) Master i Arteve në Violonçel dhe Mësuesi;
 - t) Master i Arteve në Kontrabas dhe Mësuesi;
 - u) Master i Arteve në Flaut dhe Mësuesi;
 - v) Master i Arteve në Oboe dhe Mësuesi;
 - w) Master i Arteve në Klarinetë dhe Mësuesi;
 - x) Master i Arteve në Fagot dhe Mësuesi;
 - y) Master i Arteve në Korno dhe Mësuesi;
 - z) Master i Arteve në Trombë dhe Mësuesi;
 - aa) Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi;
 - bb) Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi;



- cc) Master Profesional në Fizarmonikë dhe Mësuesi;
- dd) Master Profesional në Bastubë dhe Mësuesi.

3. Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me Diplomën përkatëse. Studimet e ofruara janë më kohë të plotë dhe zhvillohen në gjuhën shqipe.

Neni 15

Përshkrimi i programeve të studimit

1. Çdo program studimi që zhvillohet në DI, disiplinohet sipas rregullores përkatëse.
2. Në rregulloret përcaktohen të dhëna të përgjithshme të programeve, fusha e studimit, përmbajtja, forma, objektivat kryesore, plani mësimor, kreditet e detyrueshme të studimeve, klasifikimi i programit të studimeve, kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimit me numër të kufizuar, metodat e vlerësimit dhe kushtet për përparim në program, etj..
3. Me qëllim standartizimin, në hartimin e programeve të studimit, respektohen udhëzimet e MASR si dhe VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 16

Programet e studimit të Ciklit të Parë me kohë të plotë Bachelor

1. Në Departamentin e Interpretimit ofrohen programet e studimit të ciklit të parë, në:
 - a) Bachelor në Piano;
 - b) Bachelor në Fizarmonikë Klasike;
 - c) Bachelor në Violinë;
 - d) Bachelor në Violë;
 - e) Bachelor në Violonçel;
 - f) Bachelor në Kontrabas;
 - g) Bachelor në Kitarë;
 - h) Bachelor në Flaut;
 - i) Bachelor në Oboe;
 - j) Bachelor në Klarinetë;
 - k) Bachelor në Fagot;
 - l) Bachelor në Korno;
 - m) Bachelor në Trombë;
 - n) Bachelor në Trombon;
 - o) Bachelor në BasTubë.
2. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
3. Nëpërmjet programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" synohet të jepen njohuri bazë mbi metoda e parime artistike-shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në fushën specifike artistike-shkencore. Në përfundim të këtyre programeve lëshohet Diplomë "Bachelor". Programet e studimeve Bachelor realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale është 3 vite akademike.
4. Kriteret e pranimit, regjistrimit dhe realizimit të programeve të studimit të ciklit I Bachelor pranë Departamentit të Interpretimit, përcaktohen në rregulloren e programeve të studimit.

5. Kandidati fitues në programet e ofruara në DI, ka të drejtë të regjistrohet vetëm në një program studimi.
6. Procedura e regjistrimit në programet e ciklit të parë Bachelor, përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e Fakultetit të Muzikës.
- 7.

Neni 17

Programet e studimit të Ciklit të Dytë me kohë të plotë Master i Arteve, dhe Master Profesional

1. Programet e studimit të Ciklit të Dytë që ofrohen në Departamentin e Interpretimit, janë programe të një formimi special të thelluar por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë në:

- a) Master i Arteve në Piano dhe Mësuesi;
- b) Master i Arteve në Violinë dhe Mësuesi;
- c) Master i Arteve në Violë dhe Mësuesi;
- d) Master i Arteve në Violonçel dhe Mësuesi;
- e) Master i Arteve në Kontrabas dhe Mësuesi;
- f) Master i Arteve në Flaut dhe Mësuesi;
- g) Master i Arteve në Oboe dhe Mësuesi;
- h) Master i Arteve në Klarinetë dhe Mësuesi;
- i) Master i Arteve në Fagot dhe Mësuesi;
- j) Master i Arteve në Korno dhe Mësuesi;
- k) Master i Arteve në Trombë dhe Mësuesi;
- l) Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi;
- m) Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi;
- n) Master Profesional në Fizarmonikë dhe Mësuesi;
- o) Master Profesional në Bastubë dhe Mësuesi.

2. Programet e studimit të Ciklit të Dytë, “Master i Arteve”, dhe “Master Profesional” japin njohuri të thelluara specifike artistike, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në fushën e specialiteti. Këto programe realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është 2 vjet. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma në përputhje me programin e kryer “Master i Arteve”, “Master Profesional”.

3. Kriteret e pranimit, regjistrimit dhe realizimit të programeve të studimit të Ciklit II pranë Departamentit të Interpretimit, përktohen në rregulloren e programeve të studimit.
4. Kandidati fitues në programet e ofruara në Departamentin e Interpretimit, ka të drejtë të regjistrohet vetëm në një program studimi.
5. Procedura e regjistrimit në programet e ciklit të dytë Master i Arteve dhe Master Profesional, përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e Fakultetit të Muzikës.

Neni 18

Programet e studimit të Ciklit të Tretë me kohë të plotë për fitimin e Gradës Shkencore “DOKTOR” në Muzikologji



1. Programi i studimeve të doktoratës në Muzikologji që ofrohet nga njësia bazë e KMDP-së, në Fakultetin e Muzikës në UART, është program i studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, i cili ka në bazë kërkimin shkencor, projektin artistik dhe veprimtarinë krijuese të pavarur në fushën e përcaktuar nga njësia bazë e KMDP-së ku mund të aplikojnë anëtarët e personelit akademik të DI.
2. Kriteret e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimit të programeve punës kërkimore për fitimin e gradës shkencor Doktor në Muzikologji, përcaktohen në rregulloren e Programit të Doktoratës.

Neni 19

Transferimet e studimeve

1. Sipas kuotave të miratuara, DI ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha të përafërta, brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.
2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesëshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në programin e studimit që ofrohet në Departamentin e Interpretimit, i takon komisionit të ngritur për këtë procedurë me urdhër të Dekanit të FM bazuar në kriteret e miratuara për këtë qëllim. Lidhur me procedurën e transferimit, Dekani i FM harton një urdhër të veçantë në të cilin përcaktohet kjo procedurë.
3. Vendimin përfundimtar mbi vlerësimin e kandidatit nga Komisioni i ngritur për këtë procedurë e merr Dekani i FM.

Neni 20

Kriteret e procesit të transferimit të studimeve

Kritere të tjera më të detajuara mbi përafrimin apo përputhshmërinë e emërimit të programit të studimit/të syllabusve të lëndëve si dhe për njohjen e krediteve, përcaktohen në rregulloret mësimore të cikleve të studimit të Fakultetit të Muzikës dhe në rregulloren e programit të studimit.

Neni 21

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet universitare në UART zhvillohen me bazë vitin akademik.
2. Data e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministria e linjës.
3. Struktura vjetore e procesit mësimor për vitin akademik përcaktohet nga Rektori.
4. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë mësimore.
5. Çdo javë ka deri në 25 orë mësimore; lëndë speciale /leksione/ seminare ose ushtrime /laboratorë/ atelie/ praktika mësimore/ praktika profesionale, etj...
6. Planet mësimore për secilin program studimi të ofruara nga DI, miratohen nga Senati Akademik jo më vonë se tre javë përpara fillimit të vitit të ri akademik.
7. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar. Masa e frekuentimit përcaktohet në rregulloret e cikleve dhe programeve të studimit në UART. Në këtë drejtim, UART respekton standardet e përcaktuara në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e Ministrisë

përgjegjës për arsimin.

Neni 22

Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja e studimeve për programet e studimit të ofruara në Departamentin e Interpretimit, për çdo cikël studimi, bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015, Neni 90.
2. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Neni 23

Mësimdhënia

1. Në Departamentin e Interpretimit format kryesore të punës mësimore e krijuese janë lëndët e formimit artistik, lëndët artistike speciale, lëndët individuale artistike, mësimi artistik në grup, leksionet, seminarët, ushtrime, praktikat profesionale, praktikat, etj.
2. Puna mësimore zhvillohet në bazë individuale, grupi e kursi, sipas përcaktimit të akteve Ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Aktualisht DI, punën mësimore e krijuese e zhvillon në zbatim në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, duke respektuar standardet e përcaktuara në udhëzimet e MAS-it si dhe në përputhje me mundësitë reale që disponon departamenti në mjedise akademike dhe në personel.

Numri i studentëve për lëndët individuale artistike	Numri i studentëve për mësim artistik në grup	Numri i studentëve për seminarë	Numri i studentëve për praktika apo shoqërim në piano	Numri i studentëve për leksion e për leksion	Numri i studentëve në atelie/labrador
1 student	1-15 studentë	1-15 studentë	1-15 studentë	1-6 grupe seminari	1-15 studentë

4. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, jo më vonë se 1 (një) javë përpara fillimit të vitit akademik dhe të bazuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar për stafin akademik.

Neni 24

Regjistri i pedagogut

1. Ndarja e studentëve në grupe shënohet në regjistra që në fillim të vitit akademik. Regjistri i grupit është dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi dhe ngarkesën mësimore të pedagogut.
2. Çdo pedagog është i detyruar të shënojë në regjistrë:
 - a) temën e zhvilluar për çdo orë mësimi,
 - b) pasqyrimin e saktë të pjesëmarrjes së studentëve në mësim (frekuentimi),
 - c) datën dhe orët faktike të zhvilluara në mësimdhënie,
 - d) nënshkrimin e tij për secilën orë mësimore të realizuar.



3. Regjistri i pedagogut kontrollohet dhe vërtetohet mbi të dhënat e shënuara nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 25

Rregulla mbi Frekuentimin

Rregullat mbi frekuentimin e lëndëve që përmban çdo program studimi i ofruar pranë DI-së, janë të njëjta me të gjitha programet që ofrohen në FM dhe janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e këtij Fakulteti.

Neni 26

Orari i mësimit

1. Koha, studioja, klasa, auditori apo salla e zhvillimit të mësimit pasqyrohet në orarin e shpallur nga sekretaria mësimore dhe afishohet në vende të dukshme. Orari është i detyrueshëm për studentët dhe stafin akademik. Orari ndërtohet mbi kriteret pedagogjike, duke shpërndarë ngarkesën mësimore në mënyrë të balancuar.
2. Për programet e studimit që ofrohen në Departamentin e Interpretimit, orari organizohet nga zv.dekani dhe sekretaria mësimore dhe miratohet nga Dekani i FM.

Neni 27


Ora mësimore

Ora mësimore akademike zgjat 50 minuta sipas përcaktimit në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.

Neni 28

Praktikat profesionale dhe mësimore

1. Kur praktika profesionale/artistike dhe mësimore parashikohet si pjesë e planeve mësimore dhe përmban një numër kreditesh të caktuara, studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj.
2. Praktikat profesionale/artistike dhe mësimore zhvillohen në ambientet e UART ose në institucione të tjera, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti. Në DI, praktikat profesionale/artistike mund të zhvillohet edhe në mënyrë të pavarur nga institucionet bazuar në Syllabus-in përkatës dhe vlerësohen nga pedagogët e përcaktuar nga grupet mësimore. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
3. Për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës mësimore, përgjegjësi i departamentit emëron pedagogun që do të ndjekë, vlerësojë dhe plotësojë dokumentacionin e praktikës mësimore. Drejtimi i praktikave nga pedagogu përkatës, nuk përfshihet në ngarkesën mësimore në auditor dhe vlerësohet në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018, *Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL*, Pika II.12, gërma e.
4. Në rastet e kryerjes së praktikës profesionale/artistike dhe mësimore jashtë ambienteve të UART, Personeli Akademik që e drejton atë, mban lidhje me Institucionin ku ajo kryhet.
5. Në përfundim të praktikës profesionale dhe mësimore, studenti vlerësohet sipas përcaktimeve në rregulloren e programit.



- a) mësimdhënie;
 - b) Veprimtari krijuese e artistike;
 - c) Veprimtari artistike-kërkimore-shkencore;
 - d) kontribut institucional (kombëtar dhe ndërkombëtar)
 - e) kontribut profesional (kombëtar dhe ndërkombëtar)
- 2 Organizimi i mësimdhënies për programet e studimit që ofrohen në Departamentin e Interpretimit, realizohet çdo fillim viti akademik nga ky Departament.
 - 3 Në çdo fillim viti personeli akademik me kohë të plotë pranë Departamentit, nënshkruan pranë tij, marrëveshjen vjetore paraprake të kohës të punës e cila në fund të vitit akademik, rivlerësohet në bazë të aktivitetit të kryer nga personeli akademik, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në Departament. Mosplotësimi i pikave të marrëveshjes vjetore të kohës së punës, nuk i jep të drejtën e përfitimit të mbinormës personelit akademik me kohë të plotë. Përsëritja e mosplotësimit të marrëveshjes paraprake në dy vite të njëpasnjëshme, nga ana e personelit akademik, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe Statutit të UART.
 - 4 Angazhimi i personelit akademik në lëndët përkatëse përcaktohet me vendim nga Departamenti i Interpretimit.
 - 5 Në caktimin e personelit akademik sipas lëndëve, Departamenti duhet të marrë në konsideratë:
 - a) përvojën mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore në fushën përkatëse;
 - b) krijimtarinë artistike;
 - c) publikimet, aktivitetet shkencore të realizuara në fushën përkatëse;
 - d) gradën shkencore/titullin akademik që mban;
 - e) personeli akademik të mbulojë lëndë që janë brenda profilit të diplomës së tij/saj, specializimeve që mund të kenë apo mbështetur në eksperiencën e spikatur artistike të fushës, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
 - 6 Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët individuale dhe grupet mësimore të studentëve.
 - 7 Titullar i lëndës si rregull është anëtar i personelit akademik që ka titullin akademik ose gradën shkencore më të lartë. Në rast se ka dy apo më shumë anëtarë të personelit akademik që kanë të njëjtin titull/gradë shkencore, ata janë bashkë titullarë të lëndës. Kjo procedurë rregullohet në Departament rast pas rasti. Për lëndët karakterizuese (lëndët e formimit special artistik) dhe lëndët individuale artistike (LIA), ky rregull nuk mund të zbatohet. Lëndët karakterizuese (lëndët e formimit special artistik) dhe lëndët individuale artistike, mund të kenë një ose disa titullarë.
 - 8 Në rast se në lëndën përkatëse nuk ka personel akademik me titull akademik ose gradë shkencore, titullar i lëndës mund të jetë edhe njëri nga anëtarët e personelit akademik me profil të afërt me këtë lëndë. Në këtë rast titullar i lëndës mund të jetë edhe personeli akademik që i është ekuivalentuar veprimtaria artistike me gradën shkencore, sipas VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 dhe procedurave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UART.
 - 9 Organizimi i punës artistike-kërkimore-shkencore realizohet në përputhje me planifikimin që Departamenti bën në fillim të vitit akademik. Puna artistike-kërkimore-shkencore realizohet nga të gjitha kategoritë e personelit akademik në përputhje me ndarjen që ka realizuar departamenti për këtë qëllim dhe drejtohet nga kategoria e personelit akademik "Profesor".

- 10 Secili prej anëtarëve të personelit akademik ka detyrimin e vazhdueshëm të zhvillojë veprimtari-artistike-kërkimore-shkencore, në përputhje me detyrimet ligjore, profilin e tij specifik dhe planifikimin artistik dhe kërkimit shkencor.
- 11 Në përmbushje të veprimtarive, përcaktuar në pikën e mësipërme, sikurse dhe atyre të parashikuara në Nenin 13, Pika 1, të kësaj Rregulloreje, dhe në përputhje me VKM Nr. 329, datë 12.4.2017, personeli akademik, ka të drejtën e përfitimit të lejeve deri në dy javë, me miratim nga Dekani i FM. Kërkesa për leje duhet të jetë e dokumentuar me ftesën ose pranimin paraprak të institucionit, organizatës ose individit, pranë të cilit zhvillohet veprimtaria dhe dorëzohet në njësinë bazë DI. Drejtuesi i njësisë bazë ia përcjell dekanit të FM, shoqëruar me vlerësimin e tij. Në përfundim të lejes, personeli akademik duhet të paraqesë një relacion me shkrim dhe/ose dokumentacionin që vërteton zhvillimin e veprimtarive. Përrjashtim bëjnë rastet kur personeli akademik ka një marrëveshje të veçantë me Rektorin e UART.
- 12 Në Departamentin e Interpretimit mund të krijohen grupe kërkimore artistike-shkencore. Titullar i këtij grupi/grupeve do të caktohet pedagogu me titullin më të lartë akademik dhe në kushtet e barazisë së titujve, titullar do të jetë ai që ka më shumë vite përvojë krijuese e artistike dhe kërkimore- në atë fushë. Titullari i grupit/grupeve kërkimore artistike koordinon dhe drejton veprimtarinë artistike-kërkimore-shkencore në lëndën përkatëse, si dhe garanton respektimin e lirisë akademike të këtij personeli.
- 13 Departamentit i Interpretimit ka detyrimin që në çdo fillim viti akademik të përcaktojë ndarjen e personelit akademik në personel me orientim mësimor dhe me orientim artistik-shkencor, në raport me nevojat e departamentit dhe me interesin e personelit akademik.
- 14 Personeli akademik ka detyrimin të japë kontribut institucional nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, komisione apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe administrative në nivel njësie bazë, njësie kryesore apo në nivel institucioni, duke u liruar në këtë rast nga ngarkesa mësimore normale e parashikuar. Si rregull ky kontribut është i pagueshëm.
- 15 Personeli akademik pranë Departamentit ka të drejtën që, jo më vonë se dy muaj përpara fillimit të vitit akademik të paraqesë kërkesë për përfitimin e Vitit Akademik Sabatik, në përputhje me parashikimet e Statutit të UART.
- 16 Jo më vonë se 15 ditë kalendarike përpara fillimit të vitit të ri akademik, në rastet kur ka ndryshime, personeli akademik i Departamentit të Interpretimit dorëzon tek Përgjegjësi i Departamentit programin mësimor (syllabusin) në përputhje me Planin Mësimor.
- 17 Personeli akademik ka detyrimin që, jo më vonë se 2 (dy) ditë përpara provimit të lëndës që mbulon, të dorëzojë në Departament tezat e provimit për miratim.
- 18 Kontributi profesional realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte apo forma të tjera të miratuara nga Departamenti dhe/ose njësia kryesore (udhëheqje diplomash ose doktoratash, pjesëmarrje në grupe pune me karakter artistik, kërkimor, profesional etj.).
- 19 Personeli akademik i kategorisë “Profesor”/”Lektor” mund të gjenerojë (hartojë, aplikojë, zbatojë) projekte mësimore artistike, kërkimore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësisë bazë ku bën pjesë dhe mbështetur në Statutin e UART dhe gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 20 Personeli akademik me kohë të plotë ka të drejtë që të kryejë edhe veprimtari të tjera që nuk bien ndesh me statusin e tyre, me kushtin që të mos pengojë realizimin e detyrimeve ligjore ndaj UART.



KREU V
KONTROLI I NJOHURIVE DHE SISTEMI I VLERËSIMIT

Neni 29

Mënyrat e të provuarit të dijes

1. Për programet e studimit që ofrohen pranë Departamentit të Interpretimit për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Lëndët, të cilat e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë, përdorin këtë sistem vlerësimi. Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese.
2. Në vlerësimin përfundimtar të studentit, në një disiplinë apo modul të caktuar, merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, kontrollet e pjesshme, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtar është e lidhur me peshën që zënë ato në ndarjen e krediteve të lëndës sipas veprimtarive formuese të saj, të përcaktuar në planin mësimor dhe në programin e lëndës.
3. Modalitetet e vlerësimin të lëndës/modulit, shprehen në syllabus.

Neni 30

Format e kontrollit

1. Kontrolli i dijes mund të bëhet nëpërmjet:
 - a) Provimit me shkrim;
 - b) Provimit me gojë;
 - c) Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve;
 - d) Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt.
 - e) Provimi i formimit artistik konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit;
 - f) Provimi në grup (për grupet e muzikës së dhomës, ansambleve dhe orkestrave)
 - g) Provimi individual (në lëndët speciale dhe lëndët individuale artistike)
2. Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës së lëndës dhe pasqyrohet në syllabus. Në rast ndryshimi për shkaqe objektive, ndryshimi i mënyrës së organizimit të provimit i propozohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit nga titullari i lëndës mbështetur në programin e lëndës (bashkë me argumentimin për arsyen e ndryshimit) dhe miratohet përfundimisht nga Dekani. Në Departamentin e Interpretimit njihen mënyrat e organizimit të provimit si më poshtë vijon:
 - a) Provimi i lëndës individuale artistike
 - b) Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar;
 - c) Provim me gojë;
 - d) Provim me shkrim e me gojë, ku provimi me shkrim është parakusht për provimin me gojë.
 - e) Provimi në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar.
3. Mënyra dhe forma e kontrollit për çdo program dhe lëndë përcaktohet në Rregulloren e Programit dhe Syllabusin e Lëndës.



Neni 31

Parakushtet për hyrje në provim dhe Sezonet e provimeve

Parakushtet për hyrjen e studentëve në provim dhe sezonet e provimeve për programet e studimit që ofrohen pranë DI-së përcaktohen në Rregulloren e FM, atë të programit të studimit dhe syllabusin e lëndës.

Neni 32

Provimi dhe kontrolli i dijeve

1. Për programet që ofrohen në Departamentin e Interpretimit, provimet zhvillohen në orën, datën dhe ambientin e pasqyruar në orarin e provimeve, të shpallur 2 (dy) javë para fillimit të sezonit. I ngarkuari me procesin mësimor harton orarin e provimeve, mbështetur në propozimet e pedagogëve të lëndëve dhe koordinon shpërndarjen uniforme të provimeve përgjatë sezonit. Numri i datave të provimeve për çdo lëndë varet nga numri i studentëve të regjistruar për çdo lëndë.
2. Komisioni i provimit të lëndës përbëhet nga Personeli Akademik me kohë të plotë ose të ftuar, në vitin përkatës, që janë titullarë të lëndës, dhe caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Komisioni kryesohet nga Kryetari i tij, që është pedagogu me titullin Akademik më të lartë. Kryetari i komisionit të provimit emërohet nga Dekani, me propozim të Përgjegjësit të Departamentit. Komisioni i Provimit duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë.
3. Kriteret e tjera në lidhje me zhvillimin e provimeve dhe kontrollin e dijeve, përcaktohen në Rregulloren e Studimit të ciklit përkatës dhe rregulloren e programit të studimit.
4. Kushtet e kalimit në vitin pasardhës përcaktohen në Rregulloren e Ciklit të Studimit të Universitetit të Arteve.

Neni 33

Diplomimi i studentëve

Modalitetet e diplomimit

1. Në përfundim të programit të studimit, studentët, në përputhje me programin dhe ciklin e studimit, diplomohen duke përmbushur një nga katër variantet e mëposhtme:
 - a) Provim i përgjithshëm përfundimtar;
 - b) Mbrojtja artistike e diplomës;
 - c) Paraqitja e temës së diplomës me tekst dhe mbrojtje artistike e diplomës.
2. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet që përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe pa fituar numrin e krediteve siç parashikohen nga planet dhe programet mësimore sipas programit specifik të studimit.
3. Brenda 2 (dy) muajve nga data e fillimit të vitit shkollor, studentët dhe udhëheqësit e diplomës duhet të plotësojnë formularin përkatës me programin (në Bachelor) si dhe programin dhe temën e punimit teorik për diplomat master.
4. Punimi teorik dhe artistik i diplomës nuk duhet të përmbaje elemente të plagjiaturës. Për këtë arsye studenti duhet të vetëdeklarojë me shkrim mungesën e plagjiaturës në punimin e tij teorik dhe artistik.

Neni 34

Punimi i diplomës

1. Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti/programi artistik apo të një studimi me karakter përgjithësues në fushën e



programit të studimit që ka kryer. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shkrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore projektuese artistike, të tregojë aftësitë e tij profesionale - artistike dhe kompetencën për të kryer studime, projekte dhe realizime artistike në fushën përkatëse.

2. Punimi i diplomës është i lidhur me disa disiplina të përafërta dhe është individual.
3. Në përcaktimin e temave/programave të diplomës, Departamenti mund të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse.
4. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me temën/programin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe vetë një temë/program diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale, pa cënuar nivelin e cilësisë së diplomave.
5. Temat dhe udhëheqësit e diplomave, bazuar në propozimet e Njësisë Bazë, mund të rishikohen. Procedurat e rishikimit të temave, programeve të diplomës dhe udhëheqësve të tyre, përcaktohen në Rregulloret e programeve të studimit.

Neni 35

Përgatitja e diplomës

1. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit dhe përcakton programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur realizimin me sukses të temës/programit në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës.
2. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsulton dhe kontrollon punën e bërë sipas programit të miratuar.
3. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Udhëheqësi mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në përgatitjen e temës/programit të diplomës.
4. Departamenti i Interpretimit organizon kontrolle periodike, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e kryerjes së tyre. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të temës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit.
5. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës. Udhëheqësi jep mendimin e tij dhe deklarohet se volumi i planifikuar i punës është kryer dhe studentit është gati për mbrojtjen e temës së diplomës dhe më pas të mbrojtjes artistike të saj.

Neni 36

Organizimi i mbrojtjes së diplomës

1. Mbrojtja e Diplomës mund të realizohet në sezonin e verës, vjeshtës dhe dimrit. Datat e zhvillimit të mbrojtjes së Diplomave përcaktohen nga Dekani.
2. Përgatitja dhe paraqitja e punimit/programit të diplomës bëhet sipas normave të përcaktuara nga kjo rregullore dhe ndjek procedurat e miratuara nga Dekani përpara se ai të mbrohet në komisionin përkatës.
3. Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm, i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të propozuar nga Departamenti përkatës dhe të miratuar nga Dekani.

4. Mbrojtja e diplomës është publike.

Neni 37

Vlerësimi i punimit të diplomës

1. Komisioni i vlerësimit të diplomës ngrihet me urdhër të Dekanit me propozim të Përgjegjës të Departamentit.
2. Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare.
3. Në rast se studenti në sezonin e parë pas përfundimit të studimeve vlerësohet me notë negative ose nuk paraqitet për mbrojtjen e diplomës, ai mund të mbrojë punim e diplomës, brenda afateve të përcaktuara në ndjekjen e studimeve universitare.

Neni 38

Lëshimi i diplomës

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Lëshimi i diplomës për studentin që ka përfunduar një program studimi të ofruar nga Departamenti i Interpretimit, është i njëjtë me të gjitha programet e studimit që ofrohen në Fakultetin e Muzikës dhe është përcaktuar qartë në Rregulloren e këtij Fakulteti.

Neni 39

Suplementi i diplomës

Përmbajtja e suplementit të diplomës, përcaktohet në rregulloren e ciklit të studimeve dhe në rregulloren e programit të studimit.

KREU VI

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTIT

Neni 40


Marrja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në programin e ofruar pranë Departamentit të Interpretimit dhe humbet me marrjen e diplomës ose, në rast mospërfundimi të studimeve, vërtetimit të kryerjes së studimeve, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.
2. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e UART si dhe rregulloren e FM.

Neni 41

Përfundimi dhe heqja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës.



2. Statusi i studentit përfundon edhe në mënyrë të parakohëshme si më poshtë:
- Me urdhër të Dekanit, bazuar në kërkesën e studentit për çregjistrim në formën e një deklarate të përpiluar me shkrim;
 - Me propozim të Dekanit dhe vendim të Administratorit, kur vërtetohet se studenti nuk plotëson më kushtet dhe kriteret për të vazhduar të drejtën e studimit;
 - Kur dënohet me heqje të lirisë;
 - Kur braktis pa shkak studimet dhe pa u ndjekur procedurat për ndërprerjen e studimeve;
 - Me propozim të Dekanit dhe vendim të Administratorit për shkelje të rëndë ose të përsëritur të Rregullores së UART, Kodit Etik, Rregullores së FM.

Neni 42

Pezullimi i studimeve

Çdo student ka të drejtë të pezullojë studimet e tij dhe t'i rifillojë ato në çdo kohë duke paraqitur kërkesë me shkrim me argumentet përkatëse. Koha e pezullimit nuk mund të jetë me e gjatë se dyfishi i kohës së kryerjes së studimeve për atë cikël studimi. Me pezullimin e studimeve, studentit i pezullohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me programin e studimit që ai ka ndjekur. Këto të drejta dhe detyrime i kthehen me rifillimin e studimeve.

Neni 43

Të drejtat e studentëve, sjellja, detyrimet e tyre dhe veprimtaritë ekstrakurikulare


Të drejtat e studentëve, sjellja e tyre, detyrimet dhe veprimtaritë ekstrakurikulare të studentëve që ndjekin një program studimi të ofruar nga Departamenti i Interpretimit, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Fakultetit të Muzikës

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 44

- Kjo rregullore miratohet si projekt në mbledhjen e Dekanatit dhe i përcillet Senatit për miratim përfundimtar.
- Ndryshimet e Rregullores së Departamentit të Interpretimit dhe hartimi i çdo rregulloreje tjetër në zbatim të saj hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Arteve.
- Çdo ndryshim i kësaj Rregullore dhe atyre që rrjedhin prej saj propozohen nga Departamenti i Interpretimit dhe pasi miratohen nga Dekanati i përcillen Senatit për miratim përfundimtar.
- Departamenti i Interpretimit nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e kësaj rregulloreje.
- Departamenti i Interpretimit, Dekanati i FM dhe Senati Akademik kanë të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje.
- Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik



Prof. Arben Llozi



Përgjegjës i Njësisë Bazë

